

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E DYTË TË FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E SIGURISË SË DIGAVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për akordimin e një financimi shtesë në vlerën 12 milionë euro, për projektin e sigurisë së digave.

Objektivat e projektit janë:

1. Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskadën e lumit Drin;
2. Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshmërisë së sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Programi u përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vendosura për zhvillimin ekonomik të vendit dhe, gjithashtu, është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin e Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shtesa e dytë e financimit për projektin e sigurisë së digave, i cili përbën fazën e pestë të programit, konsiston në pjesët e mëposhtme:

- a) Rehabilitimi i agregatit/turbinës nr.4 dhe nr.1 në HEC Koman;
- b) Rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe remontit të HEC-ve Fierzë dhe Koman;

- c) Ndjekja (supervizioni) i aktiviteteve, të cituara më lart nga konsulenti i implementimit dhe paneli i ekspertëve të projektit të sigurisë së digave.

Financimi shtesë për projektin e sigurisë së digave do të garantojë:

- a) kompletimin e të gjithë furnizimeve dhe instalimeve dhe kryerjen e të gjitha provave, vënien në punë dhe dorëzimin agregatëve/turbinave nr.1 dhe nr.4 në HEC Koman, si dhe kryerjen e të gjitha pagesave për furnizimin dhe punimet që do të kryhen nga kontraktori;
- b) financimin e gjithë aktivitetit të konsulentit të implementimit dhe panelit të ekspertëve të projektit në rolin e asistencës për PMU dhe supervisorit të kontraktorit;
- c) financimin e gjithë aktivitetit të rehabilitimit të portave të shkarkimit dhe të remontit të HEC Fierzë dhe Koman.

Referuar zbatimit të projektit ai do të bëhet nga KESH, sh.a.-ja, deri më 31 dhjetor 2020. Fondet e kredisë do t'i nënhuazohen KESH, sh.a.-së, me të njëjtat terma të marrëveshjes së huas, nëpërmjet një marrëveshjeje nënhuaje, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit zbatues të sipërpërmendur.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i projektaktit bazohet në nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.303, datë 25.5.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", marrëveshja do t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për akordimin e një financimi shtesë në vlerën 12 milionë euro për projektin e sigurisë së digave.

Objektivat e projektit janë:

1. Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskadën e lumit Drin;
2. Rritja e sigurisë dhe e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, e cila është përgjegjëse për zbatimin e programit në tërësi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka termat financiarë të mëposhtëm:

Shuma	12 000 000 euro;
Interesi:	bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm;
Tarifa <i>Front-end</i> :	0.25% e shumës së huas;
Komision angazhimi:	0.25% që përlogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas;
Maturimi:	23 vjet duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali.

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare për periudhën 2018 – 2021.

KËSHILLI I MINISTRAVE